



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Njoftim për pozicion vakant

Në kuadrin e Projektit Tematik “TO BE READY” – “The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management – 355”, me bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi “Interreg IPA CBC Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020”, Ministria e Mbrojtjes fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës si vijon:

Menaxher Projekti për zbatimin Projektit Tematik “TO BE READY” – “The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergencY management – 355”, bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi “Interreg IPA CBC Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020”.

Detyrat e Menaxherit të Projektit:

Menaxheri i Projektit është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të projektit dhe plotësimin e detyrimeve kontraktore që rrjedhin nga zbatimi i kontratës, menaxhimi i komponentëve të ndryshëm dhe garantimin e zbatimit të të gjitha rregullave dhe procedurave, përfshirë këtu përgatitjen e raportimeve, realizimin e aktiviteteve që lidhen me fizibilitetin e projektit, etj duke synuar të kontrollojë dhe menaxhojë zhvillimin e projekti në të gjitha fazat e tij.

Përgjegjësitë specifike:

- Koordinimi dhe menaxhimi për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Projektit Tematik “TO BE READY” në bashkëpunim të ngushtë me Njesisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Mbikëqyrja e zhvillimit të aktiviteteve dhe realizimi në kohë i detyrave për arritjen e rezultateve të kërkuara;
- Dhënia e ndihmës Njesisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në Ministrinë e Mbrojtjes për çështjet lidhur me zbatimin e “TO BE READY”, konkretisht për aktiviteteve financiare në bashkëpunim me financierin e projektit, menaxhimin e buxhetit, administrative, si dhe ato juridike.
- Koordinimi me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të Projektit “TO BE READY” në bashkëpunim të ngushtë me Njesisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Raportimi dhe informimi periodik, si dhe në varësi të kërkesës së Njesisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në Ministrinë e Mbrojtjes, zyrtarët e lartë në Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me aspekte të ndryshme dhe progresin e “TO BE READY”;
- Përgatitja e raportimeve periodike sipas specifikimeve kontraktuale të projektit, në bashkëpunim të ngushtë me Njesisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes.

- Ndjekja dhe orientimi për zbatimin në kohë dhe sipas kërkesave të Planit të Prokurimeve dhe Komunikimit të projektit “TO BE READY”, si dhe në bashkëpunim me Financierin e Projektit rakordimi i nevojshëm financiar/buxhetor përplotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga projekti.
- Përditësimi, në bashkëpunim me Njësinë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA, i sistemit “elektronik Monitoring System”, si dhe ngarkimin e shpenzimeve financiare në sistem për marrje të rimbursimeve;
- Bashkëpunimi dhe ofrimi i ndihmës Njësisë Përgjegjëse për Menaxhimin e Projekteve IPA dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me procedurat audituese, për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA nga auditorë brenda dhe jashtë Institucionit Përfitues;
- Përgatitja dhe përditësimi i dosjeve fizike dhe digjitale “TO BE READY”.
- Përgatitja e korrespondencës së shkruar dhe elektronike me Ministrinë e Mbrojtjes, po ashtu edhe me institucionet e tjera Shqiptare, shoqëritë dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim zbatimin e programit.
- Pjesëmarrja dhe angazhimi në grupe të ndryshme pune të krijuar me qëllim zbatimin e “TO BE READY”.

Kërkesa të përgjithshme për pranimin e kandidatëve

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të jetë i aftë për të vepruar.
- Të përmbushë kërkesat ligjore lidhur me nivelin e edukimit, si dhe të ketë aftësi e duhura profesionale për punën përkatëse, siç kërkohet në këtë njoftim.
- Të jetë i shëndetshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrat përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar.

Edukimi, kualifikimi dhe eksperiencia

- Diplomë e nivelit të II-të “Master Shkencor”.
- Eksperiencë profesionale në fushën e kërkuar.
- Eksperiencë pune me projekte të financuara ose me struktura ndërkombëtare;
- Avantazh përbën puna të projektet të ngjashme.
- Eksperiencë në pjesëmarrje në grupe multi-disiplinore.
- Shqipe dhe Anglishte e rrjedhshme (në të shkruar dhe të folur), njohja e gjuhës italiane do të konsiderohej një vlerë e shtuar.
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim dhe shkrim.

Kërkesa të tjera

- Aftësi konceptuale, kërkimore dhe analitike për të integruar informacione nga burime të ndryshme në përfundime dhe rekomandime vepruese;
- Eksperiencë në komunikim me zyrtarë të lartë në rang kombëtar dhe/ose lokal.
- Aftësi ndërpersonale dhe të provuara në punë në mjedise multi-kulturore.
- Përgjegjësi e lartë, iniciativë dhe korrektësi.
- Diplomaci dhe aftësi për të inkurajuar dhe lehtësuar bashkëpunimin midis entiteteve qeveritare.
- Aftësi të mira kompjuterike, përfshirë Word dhe Excel.

Kushtet e punësimit

Kandidati i përzgjedhur punësohet me kohë të plotë dhe nënshkruan një kontratë me afat të caktuar me Ministrinë e Mbrojtjes.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Evropian ;
- Fotokopje të diplomave universitare, master, PhD;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Fotokopje të librezës së punës;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Formularin e vetdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM, në faqen elektronike www.mod.gov.al (linku: baza ligjore/aktet ligjore/integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i deklarimit);
- Fotokopje të Diplomave/Certifikatave që provojnë njohuritë e gjuhës angleze (nëse diploma universitare është marrë në një program studimi në gjuhën angleze ose italiane, nuk është e nevojshme dëshmia e gjuhës);
- Dokumente të tjera mbështetëse (certifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Dorëzimi i dokumenteve

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit me postë ose drejtpërdrejtë deri më datë 27/11/2019, ora 10.00, në adresën si në vijim: Ministria e Mbrojtjes, Rr. Dibrës, 1001, Tiranë, Shqipëri, me subjekt:

Aplikim për pozicionin Menaxher Projekti, Projekti Projektit Tematik “TO BE READY” – “The flood and Big fire forecast, prediction, forecast and emergency management – 355”, INTERREG IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi

Ministria e Mbrojtjes, 5 ditë mbas mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumenteve nga kandidatët do të shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të pozicionit, si dhe vendin dhe orën e zhvillimit të intervistës.

Intervista do të zhvillohet në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me :

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionin e punës (Fushën e njohurisë si më poshtë);
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimi, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Mbrojtjes do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

Fusha e Njohurisë

- Ligji Nr. 37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe

Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimin (IPA II)”;

- Ligji nr. 138/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020”
- Ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”
- VKM Nr.541 datë 18.6.2015 Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimin IPA II (2014 – 2020)
- Instrumentit të Asistencës së Para anëtarësimin IPA II (2014 – 2020) – faqja zyrtare e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Menaxhimi i fondeve IPA sipas rregullave të PRAG (<http://ec.europa.eu/europeaid/prag/document.do?nodeNumber=1>)
- Dokumentet e tjerë të programit (<https://www.italy-albania-montenegro.it>)
- Plani Kombëtar për emergjencat Civile (<http://ww.mbrojtja.gov.al/images/ec/Plani-Kombetar-EC.pdf>)